



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Mbivlerësim i të hyrave për 16,308€;
- A2 Nënvlërësim i të hyrave për 4,864€;
- A3 Nënvlërësim i pasurive (nën 1,000€) për 939€ dhe stoqeve për 2,704€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Organit Shqyrtues të Prokurimit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Në 12 raste kishte vonesa në dorëzimin e raportit të ekspertit shqyrtues.

B2 Në 54 raste kishte vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga paneli shqyrtues i OSHP-së.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

U.D. Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, U.D. Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

zv. i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, zv. i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

U.D. Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Organit Shqyrtues të Prokurimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Organit Shqyrtues të Prokurimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm.

Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregullave financiare në: procesimin e pagesave të faturave brenda afateve të përcaktuara, pasaktësi në regjistrimin e të hyrave nga konfiskimi i depozitave, pagesa e tarifës së ankesës më e ulët se tarifa e përcaktuar, vonesa në regjistrimin e të hyrave nga konfiskimi i depozitave, vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga ekspertët shqyrtues, vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga paneli shqyrtues dhe dobësi në regjistrimin e pasurive.

Raporti i auditimit ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) rekomandime janë të reja dhe tre (3) rekomandime të përsëritura. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Pasaktësi në regjistrimin e të hyrave nga konfiskimi i depozitave

Gjetja Rregullorja për të hyrat nr. 03/2010, neni 8.2 përcakton se zyrtari i të hyrave është zyrtari që i është deleguar detyra nga zyrtari kryesor financiar që të marrë përsipër aktivitete kontabël të lidhura me regjistrimin e të hyrave në SIMFK dhe barazimin e të dhënave me raportet e bankave, në pajtim me LMFPP dhe me rregullat financiare përkatëse.

Kemi identifikuar se një e hyrë e realizuar nga konfiskimi i depozitave në vlerë prej 4,332€ ishte dërguar dy herë për regjistrim në Thesar, përkatësisht me datat 16.11.2025 dhe 24.11.2025. Po ashtu, një e hyrë tjetër në vlerë prej 1,330€ ishte regjistruar gabimisht në shumën 13,306€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i gabimeve teknike nga zyrtari i të hyrave dhe mungesës së kontrolleve efektive në procesin e verifikimit dhe regjistrimit të të hyrave.

Ndikimi Si rezultat të hyrat në PFV janë mbivlerësuar për 16,308€, duke ul vlerën e depozitave për ankesa dhe rrit vlerën e të hyrave për shpenzim.

Rekomandimi A1 Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që, para dërgimit në Thesar të kërkesave për bartjen e depozitave në të hyra të Buxhetit të Kosovës, vlerat e paraqitura të jenë të sakta dhe në përputhje me dokumentacionin mbështetës përkatës. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime për korrigjimin e vlerave të evidentuara gabimisht dhe të forcohen kontrollet në procesin e regjistrimit dhe rishikimit të të hyrave, në mënyrë që të parandalohet mbivlerësimi i të hyrave dhe ndikimi i tyre në planifikimin dhe përdorimin e fondeve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesa e tarifës së ankesës më e ulët se tarifa e përcaktuar

Gjetja Rregullorja për Prokurim Publik nr. 001/2022, neni 69, përcakton se shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar të aktivitetit të prokurimit, por jo më pak se 200 € dhe jo më shumë se 10,000€.

Në 13 raste të pagesave për tarifë të ankesës që pas vendimit për konfiskim të tarifës janë regjistruar në Buxhetin e Kosovës ato ishin paguar me vlerë më të ulët se një përqind (1%) të vlerës së parashikuar. Vlera totale më e ulët se vlera që duhej paguar tarifa e ankesës është 4,864€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në procesin e verifikimit të tarifave të ankesave, ku në disa raste ishte aplikuar rregullorja e shfuqizuar, ndërsa në rastet tjera pagesat ishin realizuar sipas rregullores në fuqi.

Ndikimi Si rezultat, të hyrat e paraqitura në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) janë nënvlerësuar për 4,864€, si dhe nuk është siguruar trajtim i barabartë për të gjithë ankuesit në aplikimin e tarifave të ankesave.

Rekomandimi A2 Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në procesin e verifikimit dhe mbikëqyrjes së tarifave të ankesave, në mënyrë që pagesat të realizohen në përputhje me rregulloren në fuqi dhe të zbatohet trajtim i njëjtë për të gjithë ankuesit. Gjithashtu, duhet të sigurohet që të mos aplikohen dispozita të rregulloreve të shfuqizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mangësi në përdorimin e sistemit e-pasuria**

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6.3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Janë evidentuar dy pagesa në vlerë totale prej 939€ për inventar dhe UPS, të cilat nuk ishin regjistruar në sistemin “e-pasuria” si pasuri jo kapitale nën 1,000€. Po ashtu, tri pagesa për material shpenzues në vlerë totale prej 2,704€ nuk ishin regjistruar në sistemin përkatës për evidentimin e hyrje/daljeve të stoqeve.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, mosregjistrimi ka ndodhur për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për pranimin e mallrave dhe zyrtarëve të pagesave. Gjithashtu, sipas tyre, sistemi “e-pasuria” për menaxhimin e stoqeve nuk është plotësisht funksional, për shkak të problemeve teknike që pamundësojnë evidentimin e mallrave përmes sistemit.

Ndikimi Mosregjistrimi i pasurisë jo kapitale dhe materialit shpenzues në regjistrat përkatës ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive jo financiare në PFV duke nënvlerësuar pasuritë nën 1,000€ për 939€ dhe stoqet për 2,704€. Po ashtu rrit rrezikun për mungesë të evidencës së plotë dhe kontrollit adekuat

mbi menaxhimin e pasurisë dhe stoqeve.

Rekomandimi A3

Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që të gjitha pasuritë jo kapitale dhe materialet shpenzuese të regjistrohen me kohë dhe në mënyrë të plotë në sistemin “e-pasuria”, në përputhje me kërkesat e Rregullores MF Nr. 02/2013. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe koordinimi ndërmjet zyrtarëve përgjegjës, me qëllim të sigurimit të evidencës së saktë dhe menaxhimit efektiv të pasurisë dhe stoqeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga ekspertët shqyrtues

Gjetja Ligji i Prokurimit Publik nr 04/L-42 me plotësim ndryshim (version i konsoliduar) përkatësisht neni 114 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues paragrafi 1. Eksperti shqyrtues, në afat prej dhjetë (10) ditësh, menjëherë pas emërimit të tij do të: (i) shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse, (ii) intervistojë, nëse ai e sheh të arsyeshme ose të nevojshme, cilindo zyrtar, nëpunës ose këshilltar të autoritetit kontraktues ose palës ankuese, dhe (iii) pajisë panelin shqyrtues, ankuesin dhe kryesuesin e autoritetit kontraktues me një vlerësim me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.

Në 12 raste të vlerësimit me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë, raporti nga eksperti shqyrtues nga marrja e lëndës në shqyrtim, ka pasur vonesa nga një (1) deri në 26 ditë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës dhe mos marrjes me përgjegjësi të plotë të detyrave dhe përgjegjësive të ekspertit shqyrtues.

Ndikimi Vonesat në trajtimin e lëndëve nga ekspertët shqyrtues, mund të ndikojnë në shtyrjen e realizimit të projekteve nga autoritetet kontraktuese dhe vonesa në trajtimin e depozitave të ankuesve. Gjithashtu rrit rrezikun për vendimmarrje të anuluar apo të kontestuara në gjykatë, si dhe përballje me pasoja ligjore për OSHP-në.

Rekomandimi B1 Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që raportet e ekspertëve shqyrtues të jenë të trajtuara në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore dhe rregullative duke siguruar ligjshmërinë e tyre dhe arritjen e objektivave të OSHP-së, përfshirë misionin dhe vizionin e strategjisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga paneli shqyrtues i OSHP-së

Gjetja Ligji i Prokurimit Publik nr 04/L-42 me plotësim ndryshim (version i konsoliduar) përkatësisht Neni 117 Afati i fundit për marrjen e vendimeve, paragrafi 1. OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen e vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrin të tij.

Në 54 raste të vendimeve në trajtimin e lëndëve të ankesave nga paneli

shqyrtues i OSHP-së, ka pasur vonesa nga një (1) deri në 91 ditë.
Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës dhe mos marrjes me përgjegjësi të plotë të detyrave dhe përgjegjësive të panelit shqyrtues.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në trajtimin e lëndëve, jashtë afateve ligjore bie në kundërshtim me parimet e transparencës dhe llogaridhënies në prokurim publik, ndikon negativisht në realizimin e projekteve publike dhe në efikasitetin e shpenzimeve publike nga autoritetet kontraktuese, vonesa në depozitat e ankuesve, rrit rrezikun që palët e interesit të humbasin besimin në sistemin e ankesave ndaj OSHP-së, si dhe mund të rezultojë në kontestime të mëtejshme ligjore duke shkaktuar kosto shtesë ligjore për OSHP-ën.

Rekomandimi B2

Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që vendimet të jenë të trajtuara në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore dhe rregullative duke siguruar ligjshmërinë e vendimeve dhe arritjen e objektivave të OSHP-së, përfshirë misionin dhe vizionin e strategjisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga OSHP-ja në vitin 2025 ishin 407,263€, derisa ishin planifikuar 261,483€, duke realizuar planin për 149,780€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me konfiskimet e depozitave si rezultati i vendimeve të Paneleve Shqyrtuese. Përkundër që vendimet nga paneli shqyrtues janë për kthimin e mjeteve konform Rr. Nr.01/2020 e punës së organit shqyrtues të prokurimit- Neni 31 kthimi i tarifës për ankesë pas vlerësimit të ankesës, pika 6. Në rastin kur ankuesit i aprovohet ankesa si e bazuar, ose tërhiqet nga ankesa, atëherë ankuesi, në afat prej 60 ditëve duhet të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës në vlerën sipas nenit 13 paragrafi 7 të rregullores së punës për sigurimin e ankesës, në 19 raste me vlerë totale 82,966€, ankuesit nuk kishin bërë ankesë për kthim mjeteve dhe të njëjtat janë konfiskuar nga OSHP-ja në përputhje me rregulloren, dhe janë regjistruar e hyrë në Buxhetin e Kosovës.

Çështja A4 - Vonesa në regjistrimin e të hyrave nga konfiskimi i depozitave

Gjetja	<p>Rregullorja për të Hyrat nr. 03/2010, neni 12.1, përcakton se organizatat buxhetore duhet të bëjnë regjistrimin ditor të të hyrave në SIMFK.</p> <p>Kemi identifikuar se zyrtarja përgjegjëse për të hyrat kishte bërë kërkesat për bartjen e depozitave në të hyra të Buxhetit të Kosovës me vonesa të konsiderueshme nga data e vendimit për konfiskim deri te kërkesa për regjistrim në SIMFK, në periudha prej 3 deri në 257 ditë.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive dhe mos ushtrimit me përgjegjësi të plotë të detyrave nga zyrtarja përgjegjëse për menaxhimin dhe regjistrimin e të hyrave.</p>
Ndikimi	Vonesat në regjistrimin e të hyrave kanë ndikuar që të hyrat të mos evidentohen me kohë në SIMFK, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar.
Rekomandimi A4	Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në procesin e menaxhimit dhe regjistrimit të të hyrave, në mënyrë që bartja e depozitave në të hyra të Buxhetit të Kosovës të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe vetëm pas plotësimit të kushteve përfundimtare për konfiskim. Gjithashtu, duhet të sigurohet mbikëqyrje më efektive ndaj zyrtarëve përgjegjës për të parandaluar vonesat dhe regjistrimet në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final dhe shpenzimet për paga dhe mëditje në vitin 2025 ishin 283,427€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 35 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 25. Gjatë vitit 2025 ishin punësuar 4 të rinj. Kemi testuar 17 mostra për teste substanciale në vlerë 12,592€.

Çështja A5 - Mos nënshkrimi i akteve të reja të emërimeve

Gjetja Neni 102 i Ligji Nr. 08/L-294 për Zyrtaret Publik, paragrafi 4 përcakton se Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik.

Në tre (3) raste është identifikuar se ekspertët shqyrtues nuk kishin nënshkruar aktet e emërimit.

Mos nënshkrimi i aktë emrimeve është arsyetuar nga ekspertët shqyrtues me arsyetimin se detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në aktet e reja të emërimit bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ndikimi Mos nënshkrimi i akteve të emërimit, pa ndonjë bazë ligjore ndikon që zyrtarët të ushtrojnë detyrën pa akte të vlefshme emërimi, të cilat përbëjnë dokumentin zyrtar që dëshmon pozitën, gradën dhe kategorinë e pagës së zyrtarit në institucion.

Rekomandimi A5 Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë që të gjithë zyrtarët të ushtrojnë detyrat vetëm mbi bazën e akteve të vlefshme dhe të nënshkruara të emërimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2025 ishte 157,044€ prej tyre ishin shpenzuar 151,269€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për derivate, riparim dhe mirëmbajtje, furnizim me lëndë djegëse, komunalitet.

Çështja B3 - Vonesë në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë testimeve tona, në tetë (8) raste faturat në vlerë totale prej 7,988€, nuk ishin paguar brenda afati ligjor prej 30 ditë, por me vonesë që varioonte deri në tre muaj nga data e pranimit të obligimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Si pasojë e këtyre vonesave në pagesa, OSHP mund të përballet me kosto shtesë të interesave dhe gjobave për vonesat e kërkuara nga palët e treta në përputhje me obligimet kontraktuale.

Rekomandimi B3 Kryetari i OSHP-së duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	539,193	440,472	434,697	405,425	364,940
Grante Qeveritare - Buxheti	539,193	440,472	434,697	405,425	364,940

Buxheti final për burimet e fondeve është ulur me 98,721€, nga 539,193€ në 440,472€, kryesisht për shkak të rënies së granteve qeveritare. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka shpenzuar mbi 98% të buxhetit final ose 434,697€, me një rritje rreth 7% krahasuar me shpenzimet e vitit 2024.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	539,193	440,472	434,697	405,425	364,940
Pagat dhe mëditjet	377,738	283,428	283,428	258,801	222,079
Mallrat dhe shërbimet	156,355	151,945	150,305	145,781	141,794
Komunalitë	5,100	5,100	965	842	1,067


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: (Përshkrimet të renditen konform radhitjes në tabelën e mësipërme)

Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 94,310€ si kursime buxhetore. Kjo ka ndodhur për shkak se numri i aprovuar i stafit ishte 35 ndërsa numri i stafit gjatë vitit ishte 25 (10 më pak). Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 100%;

Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,411€ si kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 98%;

Buxheti final për komunalitë është zvogëluar për 4,135€ si rezultat i kursimeve. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 18%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Buxheti final me atë fillestar ishte i njëjtë në vlerë 261,483€ Të hyrat për vitin 2025 kanë arritur në 407,264€, ndërsa për vitin 2024 kanë qenë 555,974€, duke treguar një zvogëlim të konsiderueshme të të hyrave prej 26%.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	261,483	261,483	407,264	555,974	432,042
Të hyrat jo tatimore	261,483	261,483	407,264	555,974	432,042

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2025 të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) ka identifikuar pesë (5) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. OSHP ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2025, tre (3) nga rekomandimet nuk janë zbatuar ende, ndërsa dy (2) janë mbyllura. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që raportet e ekspertëve shqyrtues të jenë të trajtuara në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore dhe rregullative duke siguruar ligjshmërinë e tyre dhe arritjen e objektivave të OSHP-së, përfshirë misionin dhe vizionin e strategjisë. Gjithashtu, të sigurohet raportim periodik për performancën e ekspertëve shqyrtues, si dhe të ndërmerren masa për rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së tyre.	Edhe këtë vit ka pasur vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga ekspertët shqyrtues.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që vendimet të jenë të trajtuara në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore dhe rregullative duke siguruar ligjshmërinë e vendimeve dhe arritjen e objektivave të OSHP-së, përfshirë misionin dhe vizionin e strategjisë. Gjithashtu, të siguroj rishikimi të brendshëm në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të lëndëve në OSHP, për të garantuar trajtim të drejtë, të shpejtë dhe në përputhje me ligjin.	Edhe këtë vit kishte vonesa në trajtimin e lëndëve të ankesave nga paneli shqyrtues i OSHP-së	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që vendimet të jenë sa më profesionale dhe në përputhje të plotë me ligjin dhe rregulloret e prokurimit publik.	Nuk kemi hasur mostra të kësaj natyre	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i OSHP-së duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Nuk ka filluar zbatimin	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislationit në fuqi.	Nga mostrat e testuara kemi hasur vetëm në një rast të kësaj natyre.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit




Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:± 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ardian Behro
Kryesues i Sekretariatit të OSHP
Data: 16.06.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.